



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHETËTOR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakti i raportit përfundimtar i revizorit

Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizorit:

Partia Politike Bashkimi Demokratik për Integrim-BDI.

Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2020.

Qëllimi i revizionit:

Të fitohet bindje e arsyeshme nëse raportet financiare janë të lira nga paraqitjet e gabuara materialisht, dhe nëse aktivitetet dhe transaksionet janë në pajtim me rregullativën ligjore.

Gjendjet kyçe të konstatuara:

Janë paguar mjete për anëtarësim mbi limitin e lejuar ligjërisht; listat e regjistrimit nuk përmbajnë indikator vlerash, informacion për vendndodhjen ku ndodhen dhe nuk janë të shënuara me numrat e inventarit dhe nuk është bashkëngjitur dokumentacioni përkatës mbështetës për një pjesë të faturave për të cilat janë kryer shpenzime gjatë vitit 2020.

Mendimi i dhënë/përfundimi *:

Shprehëm mendim me rezervë në lidhje me paraqitjen e të vërtetës dhe objektivitetit të raporteve financiare dhe për pajtueshmërinë e transaksioneve financiare me rregullativën ligjore relevante, udhëzimet dhe politikat e vendosura.

Rekomandimet kyçe:

Të respektohen limitet e lejuara ligjërisht për anëtarësimin e përcaktuar me ligjin; të sigurohet dokumentacion mbështetës si bashkëngjitje e faturave nga furnizuesit gjatë evidentimit të transaksioneve dhe ndryshimeve afariste në librat afariste të kryet në bazë të dokumentacionit të kompletuar dhe listave të regjistrimit për mjetet materiale që të përmbajnë të dhëna dhe indikatorë të vlershëm për vendndodhjen e mjeteve të përhershëm dhe shënimin me numrat e inventarit.

Dobësitë kyçe të sistemit:

Të rishikohet dispozita ligjore në pjesën e financimit të fushatës zgjedhore me mjete nga llogaria e rregullt; saktësimi në pjesën e donacioneve nga partia politike, në lidhje me limitet individuale dhe totalit të mjeteve, ndryshimi dhe plotësimi i akteve nënligjore me të cilën rregullohet mënyra e mbajtjes së kontabilitetit të organizatave jofitimprurëse dhe rregullimin e mënyrës së pagesës dhe evidentimit të anëtarësisë si burim i financimit.

Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Nuk janë marrë vërejtje të draft-raportit të autorizuar shtetëror.

Përgjigjet e vërejtjeve të marra:

-/-

*  pozitive  me rezervë  të pavolitshëm  të përmbajtur